



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 163, datë 21.12.2012**

**PËR**  
**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË KONTRATAT-TIP PËR KRIJIMIN E**  
**PLANIT TË PENSIONIT PROFESIONAL NGA PUNËDHËNËSI NË FONDIN E**  
**PENSIONIT VULLNETAR “RAIFFEISEN”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23, të Ligjit nr. 9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 6, paragrafi 1, pika b) dhe nenit 58, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**KONSTATOJ SE:**

Shoqëria “Raiffeisen INVEST”- Shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ka sjellë në Autoritet kërkesën për miratimin e disa ndryshime në kontratat tip në rastin e krijimit të planit të pensionit profesional nga punëdhënësi. Kontratat-tip të fondit të pensionit “Raiffeisen” janë miratuar nga Bordi i Autoritetit më datë 18.10.2010, si dhe janë ndryshuar po me vendim të Bordit të Autoritetit.

Ndryshimet e paraqitura për miratim janë ndryshime thelbësore të parashikuar nga neni 6, paragrafi 1, pika b), dhe mund të kryhen vetëm me miratimin e Bordit, si dhe ndryshime të tjera, jo thelbësore për të cilat Bordi i Autoritetit mori dijeni.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e Kontratave-tip të Fondit të pensionit vullnetar “Raiffeisen”, nën administrimin e shoqërisë “Raiffeisen Invest”- shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si më poshtë:

- a) Kontrata për krijimin e planit të pensionit profesional nga punëdhënësi për punëmarrësit e tij,
  - b) Kontrata e anëtarësimit të punëmarrësit në fondin e pensionit vullnetar në kuadër të një plani pensioni profesional.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**